



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 2453 / Prot. 1

Tiranë, më 8.5. 2023

URDHËR

Nr. 220, datë 8.5. 2023

PËR

DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 501, DATË 24.12.2021 “PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI” VLORË DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË ANËTARËVE TË RINJ PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 48, 49 dhe 50 të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit Nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Në pikën 2 të urdhrin Nr. 501, datë 24.12.2021, të shtohet shkronja “ç”, si më poshtë:
“ç) Enrik Mehmeti”
2. Pika 3 e urdhrin Nr. 501, datë 24.12.2021, shfuqizohet.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

